

Luajtës CD/DVD

Udhëzuesi i referencave

DVP-SR760H



PARALAJMËRIM

Për të reduktuar rrezikun e zjarrit ose goditjeve elektrike, kjo aparaturë nuk duhet të ekspozohet ndaj shiut ose lagështirës.

Për të shmangur goditjen elektrike, mos e hapni kabinetin. Për shërbimet drejtojueni vetëm personelit të kualifikuar.

Kordoni i rrjetit elektrik duhet të zëvendësohet vetëm nga një dyqan servisi i kualifikuar. Bateritë ose aparaturën me bateri të instaluar nuk duhet të ekspozohen ndaj nxehtësisë së tepëruar siç janë drita e diellit, zjarri ose të ngjashme me to.

CLASS 1 LASER PRODUCT
LASER KLASSE 1
LUOKAN 1 LASERLAITE
KLASS 1 LASERAPPARAT



Kjo pajisje klasifikohet si produkt CLASS 1 LASER. Shenja CLASS 1 LASER PRODUCT ndodhet në pjesën e jashtme të pasme.

KUJDE

Përdorimi i instrumenteve optike me këtë produkt do të rrisë rrezikun ndaj syve. Duke qenë se rreza e lazerit të përdorur në këtë luajtës CD/DVD është e dëmshme për sytë, mos u përqipni në këtë çmontoni mobilien. Për shërbimet drejtojueni vetëm personelit të kualifikuar.

Njoftim për klientët në Mbretërinë e Bashkuar dhe Republikën e Irlandës

Për sigurinë dhe dobinë tuaj, në këtë pajisje është montuar një spinë e presuar konform me standardin BS1363.

Nëse siguresa në spinën e dhënë duhet të zëvendësohet, duhet të përdoret një siguresë me të njëjtin nivel si ajo e dhënë dhe e miratuar nga ASTA ose BSI sipas standardit BS1362, (pra e shënuar me shenjën  ose .

Nëse spina e dhënë me këtë pajisje ka një kapak siguresë që mund të shkëputet, sigurohuni që vendosni në vend kapakun e siguresës pasi të zëvendësoni siguresën. Asnjëherë mos e përdorni spinën pa kapakun e siguresës. Nëse ju humbet kapaku

i siguresës, ju lutemi kontaktoni me pikën më të afër të servisit Sony.



Hedhja e pajisjeve të vjetra elektrike dhe elektronike (e aplikueshme në Bashkimin Evropian dhe vendet e tjera evropiane me

sistem grumbullimi të diferencuar)

Ky simbol mbi produkt ose mbi paketimin e tij tregon se ky produkt nuk duhet të trajtohet si mbeturinë shtëpiake. Përkundrazi, do të dorëzohet pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike. Duke u siguruar që ky produkt të hidhet siç duhet, ju ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin, që në rast të kundërt do të shkaktoheshin nga trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të këtij produkti. Riciklimi i materialeve do të ndihmojë në ruajtjen e burimeve natyrore. Për më shumë informacion të detajuar mbi riciklimin e këtij produkti, ju lutemi kontaktoni me bashkinë tuaj, shërbimin e grumbullimit të mbeturinave shtëpiake ose dyqanin ku keni blerë produktin.



Hedhja e baterive të përdorura (e aplikueshme në Bashkimin Evropian dhe vendet e tjera evropiane me sistem grumbullimi

të diferencuar)

Ky simbol mbi bateri ose mbi paketimin tregon se bateria e dhënë me këtë produkt nuk duhet të trajtohet si mbeturinë shtëpiake. Në disa bateri, ky simbol mund të përdoret i kombinuar me një simbol kimik. Simbolet kimike për zhivën (Hg) ose plumbin (Pb) shtohen nëse bateria përmban më shumë se 0,0005% zhivë ose 0,004% plumb.

Duke u siguruar që këto bateri të hidhen siç duhet, ju ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin që në rast të kundërt do të shkaktoheshin nga trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të kësaj baterie. Riciklimi i materialeve do të ndihmojë në ruajtjen e burimeve natyrore.

Në rast produktesh të cilat për arsye sigurie, rendimenti apo integriteti të dhënash kërkojnë lidhje të qëndrueshme me një bateri të inkorporuar, kjo bateri duhet të zëvendësohet vetëm nga personel i kualifikuar shërbimi. Për të siguruar trajtimin e duhur të baterisë, dorëzojeni produktin në fund të periudhës së funksionimit të tij pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike.

Për të gjitha bateritë e tjera, ju lutemi shihni pjesën që flet mbi heqjen e sigurit të baterisë nga produkti. Dorëzojeni baterinë pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e baterive të përdorura.

Për më shumë informacion të detajuar mbi riciklimin e këtij produkti ose baterie, ju lutemi kontaktoni me bashkinë tuaj, shërbimin e grumbullimit të mbeturinave shtëpiake ose dyqanin ku keni blerë produktin.

Prodhuesi i këtij produkti është Sony Corporation, 1-7-1 Konan Minato-ku Tokyo, 108-0075 Japoni. Përfaqësuesi i autorizuar për EMC dhe sigurinë e produktit është Sony Deutschland GmbH, Hedelfinger Strasse 61, 70327 Stuttgart, Gjermani. Për çdo çështje shërbimi ose garancie, ju lutemi referojueni adresave që jepen në dokumentet e veçanta të shërbimit ose garancisë.

Masat paraprake

- Për të parandaluar rrezikun e zjarrit ose goditjeve elektrike, mbi aparaturë nuk duhen vendosur objekte të mbushura me lëng.
- Luajtësi nuk shkëputet nga burimi i rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik) për sa kohë që është i lidhur me prizën e murit, edhe nëse luajtësi vetë është i fikur.
- Mos e instaloni këtë luajtës në një hapësirë të kufizuar, si në një raft lëshose ose në një njësi të ngjashme.
- Instaljojeni këtë luajtës në mënyrë që kordoni i rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik) të mund të shkëputet nga priza e murit menjëherë në rast problemi.

- Nëse luajtësi sillel direkt nga një vend i ftohtë në një vend të ngrohtë, ose vendoset në një dhomë shumë të lagësht, lagështira mund të kondensohet mbi lentet jashtë luajtësit. Nëse ndodh kjo, luajtësi mund të mos punojë siç duhet. Në këtë rast, hiqni diskutin dhe lëreni luajtësin të ndezur për rreth gjysmë ore derisa të avullojë lagështira.


Shënim mbi disqet

Mos përdorni disqet e mëposhtme:


- Disqe të një forme jo standarde (p.sh. në formë kartoline, zemre).
- Disqe me etiketë ose letër të ngjitur mbi to.

Kodi rajonal

Luajtësi juaj ka një kod rajonal të printuar në pjesën e pasme të njësisë dhe do të luajë vetëm DVD komerciale (vetëm riprodhimi) të etiketuara me të njëjtat kode rajonale. Ky sistem përdoret për të mbrojtur të drejtat e autorit.

Në këtë luajtës do të luhen edhe DVD-të komerciale të etiketuara me .

Në varësi të DVD-së komerciale, mund të mos ketë tregues të kodit rajonal, edhe nëse luajtja e DVD-së komerciale ndalohet nga kufizimet zonale.



Kodi rajonal

Informacion mbi të drejtat e autorit, markat tregtare dhe licencën e softuerit

- Prodhuar me licencë nga Dolby Laboratories. Dolby dhe simboli me dy "D" janë marka tregtare të Dolby Laboratories.
- "DVD Logo" është markë tregtare e DVD Format/Logo Licensing Corporation.
- Patentat dhe teknologjia koduese audio MPEG Layer-3 janë të licencuara nga Fraunhofer IIS dhe Thomson.
- Windows Media është markë tregtare ose markë tregtare e regjistruar e Microsoft Corporation në Shtetet e Bashkuara dhe/ose vende të tjera. Ky produkt përmban teknologji që janë subjekt i disa të drejtave të pronësisë intelektuale të Microsoft.

Ndalohet përdorimi ose shpërndarja e kësaj teknologjie jashtë këtij produkti pa licencën/licencat përkatëse nga Microsoft.

- Ky luajtës DVD përmban teknologji High-Definition Multimedia Interface (HDMI™), në shqip: ndërfaqe multimediale me definicion të lartë. HDMI, logoja HDMI dhe High-Definition Multimedia Interface janë marka tregtare ose marka tregtare të regjistruara të HDMI Licensing LLC në Shtetet e Bashkuara dhe vende të tjera.
- Të gjitha markat e tjera tregtare janë marka të zotëruesve të tyre përkatës.
- KY PRODUKT LICENCOHET SIPAS LICENCËS SË PORTOFOLIT TË PATENTËS SË MPEG-4 VISUAL PËR PËRDORIM PERSONAL DHE JOTREGTAR NGA NJË KONSUMATOR PËR DEKODIMIN E VIDEOVE NË PËRPUTHJE ME STANDARDIN E MPEG-4 VISUAL ("MPEG-4 VIDEO") QË JANË KODUAR NGA NJË KONSUMATOR I PËRFSHIRË NË NJË AKTIVITET PERSONAL DHE JOTREGTAR DHE/OSE ËSHTË MARRË NGA NJË OFRUES I SHËRBIMIT VIDEO I LICENCUAR NGA MPEG LA PËR TË OFRUAR MPEG-4 VIDEO. NUK JEPET OSE NUK NËNKUPTOHET ASNJË LICENCË PËR ÇFARËDO PËRDORIM TJETËR. INFORMACION SHITESË, DUKE PËRFSHIRË INFORMACIONIN QË LIDHET ME LICENCIMIN DHE PËRDORIMIN PROMOCIONAL, TË BRENDSHËM DHE TREGTAR, MUND TË MERRET NGA MPEG LA, LLC. SHIHNI [HTTP://WWW.MPEGLA.COM](http://www.mpegla.com)

Mbi këtë manual

"DVD" mund të përdoret si term i përgjithshëm për DVD-të komerciale, DVD+RW/DVD+R/DVD+R DL (modaliteti +VR) dhe DVD-RW/DVD-R/DVD-R DL (modaliteti VR, modaliteti video).


Riprodhimi

Afishimi i menysë së kontrollit

Përdorni menyën e kontrollit për të zgjedhur një funksion dhe për të parë informacionin përkatës.

Shtypni DISPLAY.

Për të ndryshuar afishimin e menysë së kontrollit, shtypni sërisht DISPLAY.



- 1 Artikujt e menysë së kontrollit
- 2 Titulli i luajtur aktualisht/Numri total i titujve
- 3 Kapitulli i luajtur aktualisht/Numri total i kapitujve
- 4 Koha e luajtjes
- 5 Lloji i zgjedhur i medias
- 6 Statusi i riprodhimit
- 7 Ikona/opsionet e menysë të artikullit të zgjedhur
- 8 Mesazhi i përdorimit
- 9 Artikulli i zgjedhur i menysë së kontrollit

Lista e menysë

Artikulli Emri i artikullit, funksioni

- TITLE/SCENE/TRACK
- CHAPTER/INDEX
- TRACK

Zgjedh titullin, skenën, pjesën, kapitullin ose indeksin që do të luhet.

TIME/TEXT

Kontrollon kohën e kapërcyer dhe kohën e mbetur të riprodhimit. Vendosi kodin e kohës për kërkimin e figurës dhe muzikës (vetëm skedarët video DVD dhe Xvid).

DISC/USB

Zgjedh "USB" ose "DISC" që do të luhet.

TOP MENU/MENU

(Vetëm DVD VIDEO)
TOP MENU: Shfaq menyën kryesore.
MENU: Shfaq menyën.

ORIGINAL/PLAY LIST

Zgjedh llojin e titullit (modaliteti DVD-VR) që do të luhet: ORIGINAL ose PLAY LIST e redaktuar.

PROGRAM^{+1, *2}

Zgjedh titullin, kapitullin ose pjesën që do të luhen në rendin që dëshironi.

- 1 Zgjidhni "SET →", më pas shtypni ENTER dhe zgjidhni titullin (T), kapitullin (C) ose pjesën (T) që dëshironi të programoni, më pas shtypni ENTER.
- 2 Përsëritni duke zgjedhur titullin, kapitullin ose pjesën.
- 3 Shtypni ►.

SHUFFLE^{+1, *2}

Luan titullin, kapitullin ose pjesën në rend të rastësishëm.

REPEAT^{+1, *2}

Luan në mënyrë të përsëritur të gjithë titujt/pjesët/albumet ose individualisht një titull/kapitull/pjesë/album/skedar.

A-B REPEAT^{+1, *2}

Specifikon pjesët që dëshironi të luani në mënyrë të përsëritur.

- 1 Gjatë riprodhimit, zgjidhni "SET →" dhe më pas shtypni ENTER. Shfaqet shiriti i cilësimeve "A-B REPEAT".
- 2 Kur të gjeni pikën e nisjes (pika A), shtypni ENTER.
- 3 Kur të arrini në pikën e përfundimit (pika B), shtypni sërisht ENTER.



PARENTAL CONTROL

Vendoseni për të ndaluar riprodhimin në këtë luajtës.

PLAYER →: Riprodhimi i disa DVD VIDEO mund të kufizohet sipas një niveli të paracaktuar si p.sh. moshës së përdoruesve. Skenat mund të bllokohen ose mund të zëvendësohen me skena të tjera (Kontrolli prindëror).

PASSWORD →: Vendosni një fjalëkalim me 4 shifra duke përdorur butonat e numrave. Përdoreni këtë meny gjithashtu edhe për të ndryshuar fjalëkalimin.

Kontrolli prindëror (riprodhimi i kufizuar)

Ju mund të vendosni një nivel kufizimi të riprodhimit.

- 1 Zgjidhni "PLAYER →", dhe më pas shtypni ENTER.
Vendosni ose rivendosni fjalëkalimin tuaj me 4 shifra, dhe më pas shtypni ENTER.
- 2 Shtypni **↑/↓** për të zgjedhur "STANDARD" dhe më pas shtypni ENTER.
Shtypni **↑/↓** për të zgjedhur një zonë dhe më pas shtypni ENTER.
Kur zgjidhni "OTHERS →", zgjidhni dhe vendosni një kod standard. Shihni "LISTA E KODEVE ZONALE TË KONTROLLIT PRINDËROR" në fund të këtij manuali.
- 3 Shtypni **↑/↓** për të zgjedhur "LEVEL" dhe më pas shtypni ENTER.
Shtypni **↑/↓** për të zgjedhur nivelin dhe më pas shtypni ENTER.
Cilësimi i kontrollit prindëror është kryer. Sa më e ulët vlera, aq më i rreptë është kufizimi.
Për të çaktivizuar funksionin e Kontrollit Prindëror, vendosni "LEVEL" në "OFF".
Nëse harroni fjalëkalimin, vendosni "199703" në kutinë e fjalëkalimit, shtypni ENTER, dhe më pas vendosni një fjalëkalim të ri me 4 shifra.



SETUP

QUICK: Përdorni Konfigurimin e shpejtë për të zgjedhur gjuhën e dëshiruar të shfaqjes në ekran, raportin e pamjes së televizorit dhe sinjalin e daljes audio.

CUSTOM: Përveç cilësimit të Konfigurimit të shpejtë, mund të përshtatni cilësimet e tjera të ndryshme (faqe 8).

RESET: Rikthen cilësimet e "SETUP" te cilësimet e parazgjedhura.

ZOOM*1

Zmadhoni imazhin deri në katër herë përmasën origjinale, lëvizni duke përdorur **←/↑/↓/→**.



ANGLE

Ndryshon këndin.



CUSTOM PICTURE MODE

Zgjedh cilësinë e figurës që i përshtatet më mirë programit që shikoni.

STANDARD: Shfaq një figurë standarde.

DYNAMIC: Prodhon një figurë dinamike duke rritur kontrastin e figurës dhe intensitetin e ngjyrave.

CINEMA: Përmirëson detajet në zonat e errëta duke rritur nivelin e të zezës.

MEMORY →: Rregullon figurën në detaje më të mëdha.



SHARPNESS

Ekzagjeron konturin e imazhit për të prodhuar një figurë më të mprehtë.

OFF: Anullohet këtë opsion.

1: Përmirëson konturin.

2: Përmirëson konturin më shumë se 1.



AV SYNC

Rregulloni vonesën mes figurës dhe zërit.

Ky funksion nuk është efikas kur:

– përdorni fole të DIGITAL OUT (COAXIAL) dhe vendosni "DOLBY DIGITAL", "MPEG" ose "DTS" te "AUDIO SETUP" në përkatësisht "DOLBY DIGITAL", "MPEG" ose "ON" (faqe 8).

– lidhni një pajisje të pajtueshme me Dolby Digital ose DTS përmes folesë HDMI OUT dhe vendosni "DOLBY DIGITAL", "MPEG" ose "DTS" te "AUDIO SETUP" përkatësisht te "DOLBY DIGITAL", "MPEG" ose "ON" (faqe 8).

1 Zgjidhni "SET →", dhe më pas shtypni ENTER.

Shfaqet shiriti i rregullimit "AV SYNC".

2 Shtypni **→** në mënyrë të përsëritur për të rregulluar vonesën.

Sa herë që shtypni **←/→**, vonesa rregullohet me 10 milisekonda.

3 Shtypni ENTER.

Cilësimi i zgjedhur hyn në funksionim.

Për të rivendosur cilësimin "AV SYNC", shtypni CLEAR në hapin 2.

*1 Për t'u kthyer në luajtjen normale, zgjidhni "OFF" ose shtypni CLEAR.

*2 Modaliteti i luajtjes anulohet kur:
– hapni sirtarin e diskut.
– fikni luajtësin.

◆ Artikujt për skedarët DATA

Artikulli Emri i artikullit, funksioni

ALBUM

Zgjedh albumin që përmban muzikë dhe skedarët foto që do të luhen.

FILE

Zgjedh skedarin foto që do të luhet.

ALBUM

Zgjedh albumin që përmban skedarin video që do të luhet.

FILE

Zgjedh skedarin video që do të luhet.

DATE

Shfaq datën kur është bërë fotoja me kamera dixhitale.

INTERVAL*

Specifikon kohëzgjatjen e shfaqjes së pamjeve në ekran.

EFFECT*

Zgjedh efektet që do të përdoren për të ndryshuar pamjet gjatë një shfaqjeje rrëshqitëse.

MODE 1: Imazhet qarkullojnë në mënyrë të rastësishme përmes efekteve.

MODE 2: Imazhi lëviz nga majtas lart në djathtas poshtë.

MODE 3: Imazhi lëviz nga lart poshtë.

MODE 4: Imazhi lëviz nga e majta në të djathtë.

MODE 5: Imazhi zgjatet nga qendra e ekranit.

OFF: Fik këtë funksion.

MEDIA

Zgjedh llojin e medias që dëshironi të luani.

VIDEO: Luan skedarë video.

PHOTO (MUSIC): Luan skedarë foto dhe muzike si shfaqje rrëshqitëse. Mund të shihni një shfaqje rrëshqitëse me zë kur skedarët e muzikës dhe fotove vendosen në të njëjtin album. Nëse koha e luajtjes së muzikës ose fotove është më e gjatë, ajo që është më e gjatë vazhdon pa zë ose figurë.

PHOTO (BGM): Luan skedarë foto me sfond zërin e brendshëm të luajtësit. Për të zgjedhur melodinë e muzikës së sfondit, shtypni AUDIO në mënyrë të përsëritur ndërkohë që shihni imazhin.






MUSIC: Luan skedarë muzikorë. Shtypni SUBTITLE ndërkohë që luhen skedarë muzikorë që përmbajnë informacion të pasinkronizuar për tekstin e këngëve. Luajtësi mbështet vetëm tekst këngësh MP3 ID3.

* Në varësi të skedarit, ky funksion mund të mos jetë i disponueshëm.

Për të luajtur VIDEO CD me funksione PBC

Kur filloni të luani një VIDEO CD me funksione PBC (Playback control) shqip: kontroll i riprodhimit, shfaqet menyja për përzgjedhjen tuaj.

Për të luajtur pa përdorur funksionet PBC


Shtypni   ose butonat e numrave ndërkohë që luajtësi ka ndaluar për të zgjedhur një pjesë, më pas shtypni  ose ENTER. Për t'u kthyer te riprodhimi i PBC, shtypni  dy herë, më pas shtypni .


Kontrollimi i televizorëve me telekomandë

Ju mund të kontrolloni nivelin e zërit, burimin e hyrjes dhe çelësin e energjisë të televizorit tuaj Sony me telekomandën e dhënë.

Nëse televizori juaj është i renditur në tabelën më poshtë, vendosni kodin e duhur të prodhuesit.

Kur zëvendësoni bateritë në telekomandë, vendosni numri i kodit të duhur sërish.

1 Ndërkohë që mbani shtypur TV , shtypni butonat e numrave për të zgjedhur kodin e prodhuesit të televizorit.

2 Lëshoni TV .

Numrat e kodeve për televizorët e kontrollueshëm

Sony	01 (parazgjedhja)
Hitachi	24
JVC	33
LG/Goldstar	76
Panasonic	17, 49
Philips	06, 08, 72
Samsung	71
Sharp	29
Toshiba	38

Shikimi i pamjeve rrëshqitëse me cilësi të lartë (PhotoTV HD)

Nëse keni televizor Sony i përputhshëm me “PhotoTV HD”, mund të shijoni imazhe me cilësinë më të mirë. “PhotoTV HD” aktivizohet kur lajtësi lidhet me një televizor përmes një kablloje HDMI dhe “JPEG RESOLUTION” në “HDMI SETUP” vendoset në “PhotoTV HD” (faqe 9).



Lidhja e një pajisjeje USB

Ju mund të lidhni një pajisje USB me folenë USB të lajtësit për të lajtur skedarë video, fotosh ose muzike.

Për të hequr pajisjen USB

Ndaloni riprodhimin dhe shkëputni pajisjen USB nga foleja USB e lajtësit.


Për të ndryshuar LUN

Për disa pajisje mund të shfaqet LUN (Numri Logjik i Njësisë). Për të ndryshuar LUN ose magazinimin origjinal, shtypni   kur shfaqet lista e albumeve ose pjesëve.

Mbi pajisjet USB të mbështetura

- Ky lajtës mbështet vetëm USB Mass Storage Class.
- Ky lajtës mbështet vetëm pajisje USB të formatit FAT.
- Disa pajisje USB mund të mos funksionojnë me këtë lajtës.

Menyja CUSTOM

Ju mund të rregulloni cilësimet e ndryshme. Shtypni DISPLAY kur lajtësi është në modalitetin e ndalimit, zgjidhni  (SETUP) dhe më pas zgjidhni "CUSTOM." Shfaqet menyja CUSTOM.

Lista e menyse

Artikulli Emri i artikullit, funksioni

LANGUAGE SETUP

OSD (Gjuha e shfaqjes së ekranit): Ndërron gjuhën e paraqitjes në ekran.

MENU*¹: Zgjedh gjuhën e dëshiruar të menyse së diskut. (Vetëm DVD VIDEO)

AUDIO*¹: Ndërron gjuhën e kolonës zanore. Kur zgjidhni "ORIGINAL" zgjidhet gjuha të cilësi i jepet përparësi në disk. (Vetëm DVD VIDEO)

SUBTITLE*¹: Ndërron gjuhën e titrave të regjistruara në DVD VIDEO. Kur zgjidhni "AUDIO FOLLOW", gjuha e titrave ndryshon sipas gjuhës që zgjidhni për kolonën zanore. (Vetëm DVD VIDEO)

SCREEN SETUP

TV TYPE: Zgjedh raportin e pamjes të televizorit të lidhur.

16:9




4:3 LETTER BOX



4:3 PAN SCAN



SCREEN SAVER: Kur vendoset në "ON", ruajtësi i ekranit shfaqet kur lajtësi ndodhet në pauzë ose në modalitetin e ndalimit për 15 minuta. Shtypni  për të çaktivizuar ruajtësin e ekranit.

BACKGROUND: Zgjedh ngjyrën e sfondit ose figurës në ekranin e televizorit. Nëse vendosni "JACKET PICTURE", edhe nëse diskun nuk përmban foto Jacket, shfaqet figura "GRAPHICS".

MODE (PROGRESSIVE): Nëse zgjidhni "AUTO", lajtësi dikton formatin (film apo video) dhe e konverton në versionin e përshtatshëm.

4:3 OUTPUT: Ky cilësim është efektiv vetëm kur vendosni "TV TYPE" në "16:9." Zgjidhni "FULL" kur mund të ndryshoni raportin e pamjes në televizorin tuaj.



CUSTOM SETUP

AUTO STANDBY: Aktivizon dhe çaktivizon cilësimin e Gatishmërisë automatike. Nëse zgjidhni "ON", lajtësi kalon në modalitetin e gatishmërisë kur lihet në modalitetin e ndalimit për më shumë se 30 minuta.

AUTO PLAY: Kur vendoset në "ON", lajtësi nis riprodhimin automatikisht kur lajtësi ndizet nga një kohëmatës (nuk jepet).

PAUSE MODE: Zgjedh figurën në modalitetin e pauzës. Normalisht zgjidhni "AUTO". Kur figura del në rezolucion të lartë, vendoseni në "FRAME". (Vetëm DVD)

TRACK SELECTION: Jep kolonën zanore që përmban numrin më të lartë të prioritetit të kanaleve kur luani një DVD VIDEO në të cilin janë regjistruar një numër formatesh audio (format PCM, MPEG audio, DTS ose Dolby Digital). Nëse zgjidhni "AUTO", jepet përparësi. (Vetëm DVD VIDEO)

IMAGE QUALITY: Zgjedh shfaqjen prioritare në imazh të cilësisë së lartë ose shpejtësi të lartë. (Vetëm skedarë foto)

MULTI-DISC RESUME: Aktivizon ose çaktivizon cilësimin e rifillimit me shumë disqe. Rifillimi i riprodhimit mund të ruhet në memorie për deri në 6 DVD VIDEO/VIDEO CD të ndryshme. Nëse i nisni sërish cilësimet, fshihet pika e rifillimit. (Vetëm DVD VIDEO/VIDEO CD)



AUDIO SETUP

AUDIO DRC (Dynamic Range Control)*²: Vendosni sipas mjedisit rrethues. Vendoseni në "TV MODE" kur tingujt më të vegjël janë të padallueshëm, ose vendoseni në

"WIDE RANGE" kur mjedisi i dëgjimit është i mirë, për shembull në një kinema shtëpie.

DOWNMIX*²: Ndërron mënyrën e përzierjes së 2 kanaleve kur luani një DVD që ka elementë të pasmë tingujsh (kanale), ose regjistrohet në formatin Dolby Digital. Normalisht zgjidhni "DOLBY SURROUND."

DIGITAL OUT: Zgjedh nëse sinjalet audio dalin përmes folesë DIGITAL OUT (COAXIAL)/HDMI OUT. Kur zgjidhni "ON", vendosni edhe të mëposhtmet "DOLBY DIGITAL", "MPEG", "DTS" ose "48kHz/96kHz PCM."

DOLBY DIGITAL: Zgjedh llojin e sinjalit Dolby Digital. Vendoseni në "D-PCM" kur lajtësi lidhet me një komponent audio pa dekoder të integruar Dolby Digital.

MPEG: Zgjedh llojin e sinjalit audio MPEG. Vendoseni në "MPEG" kur luajtësi lidhet me një komponent audio me dekoder të integruar MPEG.

DTS: Zgjedh llojin e sinjalit audio DTS. Vendoseni në "ON" kur luani një DVD VIDEO me kolona zanore DTS. Mos e vendosni në "ON" kur lidhni luajtësin me një komponent audio pa dekoder DTS.

48kHz/96kHz PCM: Zgjedh frekuencën shembull të daljes së sinjalit dixhital audio. (Vetëm DVD VIDEO)

HDMI SETUP

Mund të rregulloni artikujt që lidhen me lidhjen HDMI.

HDMI RESOLUTION*³: Zgjedh llojin e sinjalit video që del nga foleja HDMI OUT. Nëse zgjidhet "AUTO (1920×1080p)" (parazgjedhja), luajtësi nxjerr sinjale video të rezolucionit më të lartë të pranueshëm për televizorin tuaj. Nëse pamja është e paqartë, jonatyrë ose që nuk ju pëlqen, provoni një opsion tjetër që i përshtatet diskut, televizorit/projektorit, etj. Për detaje, shihni gjithashtu manualin e udhëzimeve që keni marrë me televizorin/projektorin, etj.

Këtë nuk mund ta zgjidhni kur "JPEG RESOLUTION" vendoset në "PhotoTV HD."

JPEG RESOLUTION: Zgjedh llojin e rezolucionit JPEG në mënyrë që të shijoni cilësi të lartë figure përmes lidhjes HDMI. Ky cilësim është efikas vetëm kur vendosni "TV TYPE" në "16:9." Këtë nuk mund ta zgjidhni kur "HDMI RESOLUTION" vendoset në "720×480/576p." "(1920×1080i) HD

dhe "(1920×1080i) HD" janë efikase vetëm kur vendosni "HDMI RESOLUTION" në "1920×1080i." Nëse e vendosni këtë cilësim në "PhotoTV HD", "(1920×1080i) HD





ose "(1920×1080i) HD", funksionet e efekteve, rrotullimit dhe zmadhimit nuk janë të disponueshme.

YCbCr/RGB (HDMI): Zgjedh llojin e sinjalit HDMI që del nga foleja HDMI OUT. Vendoseni në "RGB" nëse figura e riprodhimit ka distorsion. Këtë nuk mund ta zgjidhni kur "JPEG RESOLUTION" vendoset në "PhotoTV HD."

AUDIO (HDMI): Zgjedh llojin e sinjalit audio që del nga foleja HDMI OUT. Vendoseni në "PCM" nëse lidhni luajtësin me një televizor që nuk është i përputhshëm me sinjalet DOLBY DIGITAL/DTS/MPEG.

*¹ Kur zgjidhni "OTHERS →", zgjidhni dhe vendosni një kod gjuhe. Shihni "LISTA E KODEVE TË GJUHËVE" në fund të këtij manuali.

*² Ky funksion ndikon daljen nga foletë e mëposhtme:
– Foletë LINE OUT L/R (AUDIO).
– Folenë DIGITAL OUT (COAXIAL)/HDMI OUT vetëm kur "DOLBY DIGITAL" vendoset në "D-PCM."

*³ Nëse figura nuk duket normale ose është bosh, rivendoseni këtë cilësim. Shtypni / për të fikur, vendosni "369" dhe më pas shtypni / për ta ndezur sërish luajtësin.

Informacion

Zgjidhja e problemeve

Nëse ju ndodh një nga vështirësitë e mëposhtme gjatë përdorimit të luajtësit, përdorni këtë udhëzues për zgjidhjen e problemeve për t'ju ndihmuar të zgjidhni problemin përpara se të kërkonti riparime. Nëse problemi vazhdon, kontaktoni shitësin më të afërt të Sony.

Energjia nuk është e ndezur.

→ Kontrolloni që kordoni i rrymës (rrjetit elektrik) të jetë lidhur mirë.

Nuk ka figurë/figura ka miza.

- Rilidhni kordonin e lidhjes mirë.
- Kordonët e lidhjes janë të dëmtuar.
- Kontrolloni lidhjen e televizorit tuaj dhe ndryshoni përzgjedhësin e hyrjes në televizor që të dalë sinjali i luajtësit në ekran.
- Disku është i papastër ose me defekt.
- Shtypni **I/⏪** për të fikur luajtësin, më pas vendosni "369" me butonat e numrave në telekomandë, më pas shtypni **I/⏪** për ta ndezur sërish luajtësin.

Nuk ka zë.

- Rilidhni kordonin e lidhjes mirë.
- Kordoni i lidhjes është i dëmtuar.
- Luajtësi është në modalitetin e pauzës ose në modalitet luajtjeje me lëvizje të ngadalta.
- Luajtësi është në modalitet përshpejtimi prapa ose para.

Telekomanda nuk funksionon.

- Bateritë në telekomandë kanë rënë.
- Telekomanda nuk është drejtuar drejt sensorit të telekomandës **IR** në luajtës.
- Kur e përdorni luajtësin duke shtypur butonat në telekomandë në sekuencë, shtypni butonat brenda 5 sekondave nga njëri-tjetri.

Disku nuk luan.

- Disku është në anën e kundërt.
Futeni diskun me anën e luajtjes drejtuar poshtë.
- Disku është i gërvishtur.
- Luajtësi nuk mund të luajë disa lloje disqesh.
- Kodi rajonal në DVD nuk përputhet me luajtësin.
- Brenda luajtësit është kondensuar lagështirë.
- Luajtësi nuk arrin të luajë një disk të regjistruar që nuk është finalizuar siç duhet.

Luajtësi nuk punon siç duhet.

→ Kur elektriciteti statik, etj. shkakton që luajtësi të mos punojë normalisht, shkëputeni luajtësin.

"C:13:*"* sfaqet në ekranin e televizorit.

→ Pastroni diskun me një pëllhurë pastrimi ose kontrolloni formatin e tij.

Nuk ka figurë/zë kur e lidhni me folenë HDMI OUT.

- Ndryshoni cilësimin "HDMI RESOLUTION" te "HDMI SETUP." Problemi mund të zgjidhet.
- Pajisja e lidhur me folenë HDMI OUT nuk përputhet me formatin e sinjalit audio, në këtë rast vendoseni "AUDIO (HDMI)" te "HDMI SETUP" në "PCM."
- Provoni të mëposhtmet: ①Fikni dhe ndizni luajtësin. ②Fikni dhe ndizni pajisjen e lidhur. ③Shkëputni dhe pastaj rilidhni sërish kordonin HDMI.

Luajtësi nuk dikton pajisje USB të lidhur me luajtësin.

- Pajisja USB nuk është lidhur mirë me luajtësin.
- Pajisja USB ose një kordon është dëmtuar.
- Modaliteti i diskut nuk është kaluar në modalitetin USB.

Format i luajtshëm i diskut

Video: MPEG-1 (të dhëna Cyber-shot)/
MPEG-4 (profil i thjeshtë)*¹/Xvid

Foto: JPEG (format DCF)

Muzikë: MP3 (përveç mp3PRO)/WMA
(përveç WMA Pro)*¹, *²/AAC*¹, *²/LPCM/
WAVE

*¹ Skedarë me mbrojtje të të drejtave të autorit
(Digital Right Management) nuk mund
të luhen.

*² Luajtësi nuk luan skedarë të koduar siç
janë Lossless.

Prapashtesat e mbështetura: “.avi”, “.mpg”,
“.mpeg”, “.mp4”, “.jpg”, “.mp3”, “.wma”,
“.m4a”, “.wav”

Disqet e mbështetura: DVD, DVD±RW/±R/
±R DL, Music CD/Super VCD, CD-R/-RW

- DATA CD të regjistruara sipas ISO 9660
Niveli 1/Niveli 2, ose formatit të tij të
zgjatur, Joliet.
- DATA DVD të regjistruara sipas UDF.
- Luajtësi do të luajë çdo skedar në formatet
e mësipërme, edhe nëse formati i skedarit
ndryshon. Luajtja e këtyre të dhënave mund
të krijojë zhurmë që mund të rezultojë në
dëmtim të altoparlantëve.
- Luajtja e një hierarkie komplekse të dosjeve
mund të kërkojë kohë. Krijoni albume me jo
më shumë se dy hierarki.
- Disa skedarë video, foto ose muzike mund
të mos luhen, në varësi të kodimit/kushteve
të regjistrimit.
- Për të nisur riprodhimin dhe për të
vazhduar në albumin/skedarin tjetër mund
të duhet kohë.
- Luajtësi do të njohë një maksimum prej
200 albumesh dhe 600 skedarësh. Ai mund
ët njohë deri në 300 skedarë muzikorë dhe
300 skedarë fotos kur zgjidhet
“PHOTO (MUSIC)”.
- Luajtësi mund të mos luajë një kombinim
prej dy ose më shumë skedarë video.
- Luajtësi mund të mos luajë një skedar video
me përmasë më të madhe se 720 (gjerësi) ×
576 (lartësi)/2 GB.
- Në varësi të skedarit, riprodhimi mund të
mos ecë mirë. Rekomandohet që të krijoni
një skedar me shpejtësi bit më të vogël.
- Luajtësi mund të mos riprodhojë mirë
skedarë video në DATA CD me shpejtësi bit
të lartë. Rekomandohet që t'i riprodhoni
duke përdorur DATA DVD.

- Kur luhen të dhëna vizuale që nuk
mbështeten nga formati MPEG-4, do të
dëgjohe vetëm zëri.

Shënime mbi mjetet e regjistrueshme

Disa mjete të regjistrueshme mund të mos
luhen në këtë luajtës për shkak të cilësisë së
regjistrimit ose gjendjes fizike të diskut, ose
karakteristikave të pajisjes regjistruese dhe
softuerit krijues. Disku nuk do të luhet nëse
nuk është finalizuar siç duhet. Gjithashtu,
disa disqe DATA të krijuar në formatin
Packet Write nuk mund të luhen.

Vetëm për luajtës që nuk mund të luajë imazhe që përbajnë mbrojtje kundër kopjimit

Imazhet në modalitetin DVD-VR me CPRM
(Content Protection for Recordable Media)
në shqip: mbrojtja e përbajtjes për mjetet
e regjistrueshme, mund të mos luhen.

Shënim mbi përdorimin e riprodhimit të DVD-ve dhe VIDEO CD-ve

Disa funksione përdorimi të riprodhimit të
DVD-ve dhe VIDEO CD-ve mund të jenë
vendosur qëllimisht nga prodhuesit
e softuerit. Duke qenë se ky luajtës i luan
DVD-të dhe VIDEO CD-të sipas përbajtjes
të projektuar të diskut nga prodhuesit
e softuerit, disa veçori të riprodhimit mund
të mos jenë të disponueshme. Referojuni
gjithashtu udhëzimeve të përdorimit të dhëna
me DVD-të ose VIDEO CD-të.

Shënime mbi disqet

Kjo njësi është projektuar të riprodhojë disqe
që janë konform me standardin e kompakt-
diskut (CD). DualDisc-ët dhe disa disqe
muzikore me teknologji për mbrojtjen e të
drejtave të autorit nuk janë konform me
standardin e kompakt-diskut (CD). Prandaj,
këto disqe mund të mos jenë të përputhshëm
me këtë njësi.

Specifikimet

Sistemi

Lazeri: Lazer gjysmëpërçues

Hyrjet/daljet

- LINE OUT L/R (AUDIO): Foleja e fonisë
- DIGITAL OUT (COAXIAL): Foleja e fonisë
- LINE OUT (VIDEO): Foleja e fonisë
- HDMI OUT: Konektor standard HDMI me 19 kunjë
- USB: Foleja USB e llojit A, rryma maksimale 500 mA (Për lidhjen e pajisjes USB)

Të përgjithshme

- Furnizimi me energji: 220-240 V AC, 50/60 Hz
- Konsumi i energjisë: 10 W
- Përmasat (afërsisht): 270 × 38.5 × 209 mm (gjerësi/lartësi/thellësi) duke përfshirë pjesët projektuese
- Masa (afërsisht): 950 g
- Temperatura ku mund të përdoret: 5 °C deri 35 °C
- Lagështira ku mund të përdoret: 25% deri 80%

Aksesorët e dhënë

- Telekomanda (1)
- Bateri R6 (përmasa AA) (2)

Specifikimet dhe dizajni janë subjekt ndryshimi pa dhënë njoftim.

LISTA E KODEVE TË GJUHËVE

📄 faqe 8

Kodi Gjuha	Kodi Gjuha	Kodi Gjuha	Kodi Gjuha
1027 Afar	1183 Irish	1347 Maori	1507 Samoan
1028 Abkhazian	1186 Scots Gaelic	1349 Macedonian	1508 Shona
1032 Afrikaans	1194 Galician	1350 Malayalam	1509 Somali
1039 Amharic	1196 Guarani	1352 Mongolian	1511 Albanian
1044 Arabic	1203 Gujarati	1353 Moldavian	1512 Serbian
1045 Assamese	1209 Hausa	1356 Marathi	1513 Siswati
1051 Aymara	1217 Hindi	1357 Malay	1514 Sesotho
1052 Azerbaijani	1226 Croatian	1358 Maltese	1515 Sundanese
1053 Bashkir	1229 Hungarian	1363 Burmese	1516 Swedish
1057 Byelorussian	1233 Armenian	1365 Nauru	1517 Swahili
1059 Bulgarian	1235 Interlingua	1369 Nepali	1521 Tamil
1060 Bihari	1239 Interlingue	1376 Dutch	1525 Telugu
1061 Bislama	1245 Inupiak	1379 Norwegian	1527 Tajik
1066 Bengali;	1248 Indonesian	1393 Occitan	1528 Thai
Bangla	1253 Icelandic	1403 (Afan)Oromo	1529 Tigrinya
1067 Tibetan	1254 Italian	1408 Oriya	1531 Turkmen
1070 Breton	1257 Hebrew	1417 Punjabi	1532 Tagalog
1079 Catalan	1261 Japanese	1428 Polish	1534 Setswana
1093 Corsican	1269 Yiddish	1435 Pashto;	1535 Tonga
1097 Czech	1283 Javanese	Pushto	1538 Turkish
1103 Welsh	1287 Georgian	1436 Portuguese	1539 Tsonga
1105 Danish	1297 Kazakh	1463 Quechua	1540 Tatar
1109 German	1298 Greenlandic	1481 Rhaeto-	1543 Twi
1130 Bhutani	1299 Cambodian	Romance	1557 Ukrainian
1142 Greek	1300 Kannada	1482 Kirundi	1564 Urdu
1144 English	1301 Korean	1483 Romanian	1572 Uzbek
1145 Esperanto	1305 Kashmiri	1489 Russian	1581 Vietnamese
1149 Spanish	1307 Kurdish	1491 Kinyarwanda	1587 Volapük
1150 Estonian	1311 Kirghiz	1495 Sanskrit	1613 Wolof
1151 Basque	1313 Latin	1498 Sindhi	1632 Xhosa
1157 Persian	1326 Lingala	1501 Sangho	1665 Yoruba
1165 Finnish	1327 Laothian	1502 Serbo-	1684 Chinese
1166 Fiji	1332 Lithuanian	Croatian	1697 Zulu
1171 Faroese	1334 Latvian;	1503 Singhalese	
1174 French	Lettish	1505 Slovak	
1181 Frisian	1345 Malagasy	1506 Slovenian	1703 Nuk specifikohet

ISO 639: Standardi 1988 (E/F)

LISTA E KODEVE ZONALE TË KONTROLLIT PRINDËROR

📄 faqe 5

Kodi Zona	Kodi Zona	Kodi Zona	Kodi Zona
2044 Argjentina	2109 Gjermania	2304 Korea	2501 Singapori
2047 Australia	2376 Holanda	2363 Malajzia	2149 Spanja
2046 Austria	2248 India	2184 Mbretëria	2499 Suedia
2057 Belgjika	2238 Indonezia	e Bashkuar	2528 Tajlanda
2070 Brazili	2254 Italia	2362 Meksika	2390 Zelanda e Re
2115 Danimarka	2276 Japonia	2379 Norvegjia	2086 Zvicra
2424 Filipinet	2079 Kanada	2427 Pakistani	
2165 Finlanda	2090 Kili	2436 Portugalia	
2174 Franca	2092 Kina	2489 Rusia	

💡 Për të mësuar sekrete, këshilla dhe informacione të dobishme rreth produkteve dhe shërbimeve Sony, ju lutemi vizitoni faqen:



* | - 4 4 0 0 8 3 6 4 1 + *

4-400-836-41(1) (AL)

<http://www.sony.net/>